

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/14 dhe 83/18) dhe nenin 124 paragrafi (1) alineja 3 të Ligjit për Procedurat e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 124/2015), duke vepruar sipas propozimit për shpalljen e aktvendimit si të pavlefshme, e dorëzuar nga KAPPA STAR RESAJKLING SHPK, Umka, rr. trembëdhjetë Tetori nr. 1, Umka, Serbi, dhe NUTRIVET SHPK Shkup, rr. Lisec nr. 1B Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, të dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Debarliev Dameski dhe Qeleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 03.10.2024, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

1. Propozimi për shpalljen si të pavlefshme të Aktvendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa. nr. 08-21 të datës 20.03.2024, dorëzuar nga KAPPA STAR RESAJKLING SHPK, Umka, rr. trembëdhjetë Tetori nr. 1, Umka, Serbi, dhe NUTRIVET SHPK Shkup, rr. Lisec nr. 1B Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, PRANOHET.
2. Aktvendimi i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa. nr. 08-21 të datës 20.03.2024 shpallet i PAVLEFSHËM (NUL) PËR SHKAK SE NUK MUND TË ZBATOHET.

ARSYETIM

KAPPA STAR RESAJKLING SHPK, Umka, rr. trembëdhjetë Tetori nr. 1, Umka, Serbi, dhe NUTRIVET SHPK Shkup, rr. Lisec nr. 1B Shkup, më 18.09.2024 dorëzuan një shkresë në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vazhdim, Komisioni) me kërkesën që Komisioni të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Komisionit Pa. nr. 08-21 nga 20.03.2024.

Në shkresë, KAPPA STAR RESAJKLING SHPK, Umka, dhe NUTRIVET SHPK Shkup, theksojnë se baza ligjore e përqendrimit (Memorandum i Mirëkuptimit nga 05.06.2023) për të cilin është dorëzuar Njoftimi për përqendrim më 05.07.2023 nga ana e KAPPA STAR RESAJKLING SHPK dhe NUTRIVET SHPK Shkup dhe në bazë të të cilit Komisioni ka miratuar vendimin pa. nr. 08-21 nga 20.03.2024 është anuluar me marrëveshje të ndërsjellë.

Marrëveshja për anulimin e Memorandumit të Mirëkuptimit nga 05.06.2024 është dorëzuar si shtesë në shkresë.

Në përputhje me këtë, dhe për shkak të pamundësisë për përmbushjen e obligimeve nga KAPPA STAR RESAJKLING SHPK dhe NUTRIVET SHPK Shkup të urdhëruara me vendimin e Komisionit aa. nr. 08-21 nga 20.03.2024, KAPPA STAR RESAJKLING SHPK dhe NUTRIVET SHPK Shkup kërkojnë që Komisioni të marrë një vendim të duhur që do të konstatojë përfundimin e bazës ligjore të përqendrimit në fjalë dhe anulimin e vendimit.

Komisioni me aktvendimin aa. nr. 08-21 nga 20.03.2024:

1. Konstaton se përqendrimi për të cilin është dorëzuar njoftimi nga KAPPA STAR RESAJKLING SHPK, Umka, rr. trembëdhjetë Tetori nr. 1, Umka, Serbi, dhe NUTRIVET SHPK Shkup, rr. Lisec nr. 1B Shkup, me të cilin KAPPA STAR RESAJKLING SHPK dhe NUTRIVET SHPK Shkup synojnë të bashkojnë biznesin për grumbullimin, transportin, ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve jo të rrezikshme të NUTRIVET SHPK Shkup, me biznesin e EKO STAR RECIKLAYHA SHPKNJ Shkup me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 87 Shkup – Kisela Vodë, dhe gjithashtu EKO STAR RECIKLAYHA SHPKNJ Shkup do të blejnë pajisjet për transportin e mbetjeve jo të rrezikshme nga Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime EKOPAK SKS SHPK Shkup me seli në rr. Gjorgji Abaxhiev nr. 12 Shkup, nuk do të ketë

për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore,, sidomos si rezultat i krijimit ose forcimit të një pozite dominuese të palëve në përqendrim dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptimin e nenit 20 paragrafi (1) pika 1) të këtij Ligji, me kusht që të plotësohen obligimet e marra të dorëzuara më 15.03.2024, sipas nenit 20 paragrafi (1) pika 3) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. U cakton obligimin që parashtruesit e njoftimit KAPPA STAR RESAJKLING SHPK, Umka, rr. trembëdhjetë Tetori nr. 1, Umka, Serbi, dhe NUTRIVET SHPK Shkup, rr. Lisec nr. 1B Shkup të përmbushin plotësisht "Propozimi i ndryshuar i obligimeve të palëve për të arritur që përqendrimi të jetë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës", të dorëzuara me shkresë nga 15.03.2024, në mënyrën dhe brenda afateve të përcaktuara në Obligimet e Ndryshuara, për të arritur që përqendrimi të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni e vlerësoi pretendimin e paraqitur në kërkesë se përqendrimi i lartpërmendur nuk është realizuar, përkatësisht se nuk janë përmbushur obligimet e vendosura me vendimin brenda afatit të caktuar, si dhe se është anuluar baza ligjore e përqendrimit, përkatësisht se më 17.09.2024 është nënshkruar Marrëveshja për anulimin e Memorandumit të Mirëkuptimit nga 05.06.2024 dhe i pranoi ato si arsye për të cilat Aktvendimi i Komisionit PA. nr. 08-21 nga 20.03.2024 nuk mund të zbatohet.

Çdo përqendrim i ardhshëm ndërmjet KAPPA STAR RESAJKLING SHPK, Umka, rr. trembëdhjetë Tetori nr. 1, Umka, Serbi, dhe NUTRIVET SHPK Shkup, rr. Lisec nr. 1B Shkup, nëse ka, do të përfaqësojë një përqendrim të ri për të cilin do të ketë obligim për dërgimin e njoftimit në Komision në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Udhëzimi për mjetet juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij. Padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска